

## Parazitologjia I

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë Departamenti i Mjekësisë Veterinare</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Parazitologji I</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Mjekësi Veterinare</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>III (Semestri VI)</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3/2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>8:30 – 10:45 h, Institut</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. Dr. Kurtesh Sherifi</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b>kurtesh.sherifi@uni-pr.edu</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Parazitologjia përbëhet nga kurset teorike dhe praktike, e cila ka për qëllim të njoh studentët me faktet themelore dhe konceptet në Parazitologjinë Veterinare, kontrollin dhe parandalimin e sëmundjeve parazitare për ti eliminuar ose reduktuar humbjet ekonomike, zoonozat parazitare, dhe për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve. Leksionet kryesore fillojnë me Endo-dhe Ektoparazitet e kafshëve shtëpiake, të cilat janë me rëndësi kombëtare ose ndërkombëtare dhe me rëndësi praktike në mjekësinë veterinare. Theksi është vendosur në njohuritë themelore të biologjisë së parazitit, epidemiologjisë, patogjenezës, diagnozës, terapisë dhe kontrollit të infeksioneve parazitare.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kurseve teorike dhe praktike është të nxjerrë në pah dhe për të zgjeruar njohuritë e parazitëve dhe sëmundjeve parazitare të rëndësishme, sidomos morfologjinë e parazitëve, ciklin biologjik, epidemiologjinë, patogjenezën e sëmundjes, shenjat klinike, diagnozën dhe mjekimin. Në pjesën praktike studentët njihen me metodat e diagnostikimit, duke përfshirë interpretimin e rezultateve. Ata vëzhgojnë fazat e parazitëve në gjak, mostra fekale dhe përgatitjen e një sërë mostrave për diagnostifikim. Mësimi në parazitologji veterinare është bazuar në njohuritë e një numri të lendeve, nga provimet përfundimtare në zoologji, biologji, kimi, anatomi dhe histologji, fiziologji dhe biokimi. Njohuritë nga parazitologjia, studentëve u kontribuon në studimet e tyre të mëtejshme të tilla si patologji, mjekësi të brendshme dhe të higjienës së ushqimit.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>1. Njohje me parazitët dhe sëmundjet parazitare në</p>

	kafshë 2. Njohje me sëmundjet zoonotike parazitare 3. Punë praktike në marrje të mostrave dhe analiza parazitologjike 4. Njohje me trajtimin e kafshëve me antiparazitar		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	5	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	5
Ushtrime në teren	1	5	5
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	1	10	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Projektet,prezentimet ,etj	1	3	3
<b>Totali</b>			<b>150 ore</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata Diskutime në grupe, Seminare Punë praktike		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë: 15% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10% Vijimi i rregullt: 10% Provimi final: 50% Total: 100%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	ECKERT. J, FRIEDHOFF. K.T, ZAHNER.H, DEPLAZES.P. (2009): Lehrbuch der Parasitologie fuer Tiermedizin. BOCH, J., SUPPERER, R., (2000, 2005): Veterinärmedizinische Parasitologie, begründet von J. Boch und R. Supperer (M. Rommel, J. Eckert, E. Kutzer, W. Körting, Th. Schnieder).		

	<p>D. BOWMAN, (seventh edition), (1999): Georgis' Parasitology for Veterinarians.  Parazitologjia e pergjithshme dhe Helmintologjia veterinare (S. Zanaj)-botuar ne vitin 1998  Protozologjia dhe Araknoentomologjia veterinare (S. Zanaj)-botuar ne vitin 1997.  MERCK VETERINARY MANUAL – 9th Edition (2005).</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Kassai, T. / Reed Educational and Professional Publ. Veterinary Helminthology.  Wall, R., Shearer, D. / Iowa State Press  Veterinary Ectoparasites: Biology, Pathology and Control.  Foreyt, W.J. / Blackwell  Veterinary Parasitology – Reference manual.</p>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e parë:</i>	<b>Parazitologjia e pergjithshme:</b> Format e bashkëjetesës së organizmave; Nociione të rëndësishme në parazitologji; Sistematika, taksonomia dhe karakteristikat e pergjithshme të parazitëve; Mardheniet parazit-nikoqir (përbujtës)
<i>Java e dytë:</i>	<b>Parazitologjia e pergjithshme:</b> Parazitët, përbujtësi dhe ambient; Ndikimi i ambientit të jashtëm në parazitë dhe cikli biologjik i tyre; Prekshmeria dhe Specifiteti, Infeksioni/Infestimi dhe rrugët e hyrjes së parazitëve në organizëm; Patogjeniteti dhe virulenca e parazitëve; Mekanizmat mbrojtës të organizmave kundër parazitëve dhe imuniteti
<i>Java e tretë:</i>	Fasciolosis, facioidosis, Paramphistomatidosis, dicrocoeliosis, shistostomatidosis
<i>Java e katërt:</i>	Cysticercosis, hydatidosis, coenurosis
<i>Java e pestë:</i>	Hyostromylosis, amidostomosis, ollulanosis, trichostrongylidosis
<i>Java e gjashtë:</i>	Ancylostomatidosis, strongyloidosis, nematodet e mishengrensve
<i>Java e shtatë:</i>	Nematodet e kuajve, derrave, ruminanteve dhe shpendeve
<i>Java e tetë:</i>	Strongylidosis, strongylosis, cyathostominosis, oesophagostomosis
<i>Java e nëntë:</i>	Oxyuriasis, trichuriasis, chabertiosis, passalurosis, syngamosis
<i>Java e dhjetë:</i>	Krimbat e mushkërive te kuajt, ruminantet, derrat dhe

	mishengrensit
<b><i>Java e njëmbëdhjetë:</i></b>	Dirofilariosis, trichinellosis
<b><i>Java e dymbëdhjetë:</i></b>	Habronematidosis, spirocercosis, thelaziosis, parafilariosis
<b><i>Java e trembëdhjetë:</i></b>	Onchocercosis, setariosis, capillariosis, macracanthorchyncosis
<b><i>Java e katërbëdhjetë:</i></b>	Kontrolli dhe Luftimi i Helmintëve
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></b>	Përmbledhje e infeksioneve me helmint sipas perbuktesit dhe organit

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Pjesëmarrje e rregullt në ligjëratat (70%) dhe ushtrime (100%)</li> <li>- Edukata në rregullat themelore: qetësi dhe vëmendje gjatë mësimit</li> <li>- Prezenca me kohë në sallë të mësimit ose laborator</li> </ul>	